



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100921/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimi i të dënuarve/paraburgosurvenë Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin.*

Drejtuar: **Z. Agim ISMAILI**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Artan TABAKU
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

PEQIN

Të nderuar Zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin më datë 17.06.2021, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Besnik Deda me detyrë nd/ komisionerë pranë këtij Mekanizmi.

Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)-në Peqin, cilësia e trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve brenda tij, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektiveve të mëparshme. Vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit u takua fillimisht me drejtorin e institucionit z. Artan Tabaku. Nga ana e drejtuesit të këtij institucioni, grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për të kryer vizita në të gjithë ambientet që duhet të monitoronin, si dhe për zhvillimin e takimeve dhe intervistave konfidenciale me personat e dënuar/ paraburgosur.

Gjithashtu grupi inspektues i Mekanizmit Kombëtar përgjatë inspektimit i kushtoi fokus të veçantë dhe masave të marra nga institucioni mbi parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19.

Sipas informacionit dhe nga verifikimi i këtyre masave, rezultoi se zbatohet protokollin shëndetësor për masat anti Covid-19. Në hyrje të institucionit, punonjësi i shërbimit kryente matjen e temperaturës me termometër digital, si dhe kalohej në urën dezinfektuese, duke i evidentuar në një libër të veçantë për çdo punonjës dhe vizitor.

Personeli i institucionit, zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, duke ruajtur distancimin fizik dhe social, si dhe në mbajtjen e higjienës personale.

Urdhërat, udhëzimet dhe protokollin shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë, ishin të afishuar në hyrje të institucionit, zyrat e administratës dhe në hyrje të regjimit të brendshëm.

Ishin shmangur ose minimizuar grumbullimet e stafit në rreshtime, mbledhje dhe kontaktet me të dënuarit dhe njëkohësisht ishin dhënë porosi të dënuarve dhe të paraburgosurve, që mos të krijoheshin grumbullime gjatë orareve të veprimeve të përbashkëta.

Personeli shëndetësor i institucionit për kontrollin e menaxhimin e gjendjes shëndetësore të të dënuarve dhe të paraburgosurve, një herë në javë kishte ushtruar kontrole, rezultatet e të cilave ishin evidentuar në libra të veçantë.

Për të dënuarit dhe të paraburgosurit të cilët për arsye shëndetësore kishin shkuar në urgjencën e spitalit apo në klinikë private stomatologjike, pas kthimit në institucion ishin karantinuar 14 ditë (Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve) në sektorin e observimit, sipas protokollit shëndetësor.

Masa më e rëndësishme është se, që në fillim të pandemisë ishin ndërprerë takimet me familjarë dhe ishte lejuar vetëm sjellja e ushqimeve, të cilat pasi kontrolloheshin, më pas mbaheshin 4 orë pa ju dorëzuar të paraburgosurve, si kusht i protokollit, që edhe ushqimet të mos shërbejnë si transmetues të infeksioneve. Në ditën e inspektimit 17.06.2021 konstatoam se prej datës 14 Qershor në I.E.V.P. Peqin kishin rifilluar takimet me familjarët kjo sipas Urdhërit të Ministrisë së Drejtësisë Nr.6285/1 datë 11.06.2021 “*Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 në institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale*”.

Lehtësimi i masave kufizuese në sistemin e burgjeve, është fokusuar në tre drejtime:

1. Rifillimi i kufizuar të takimeve me familjarët, dhe të afërmeve të tyre.
2. Rifillimi i dhënies së lejeve të veçanta.
3. Si dhe rifillimi i aktiviteteve sociale dhe kulturore, në institucionet penitenciare.

Konkretisht, masat e reja kanë filluar të zbatohen nga data 14 qershor për një periudhë e cila do të jetë nën monitorim të vazhdueshëm nga të gjitha strukturat shëndetësore dhe ekipi drejtues i DPB-së dhe i burgjeve. Këto masa konsistojnë konkretisht:

1. Rifillimin e lejimit të takimeve të të dënuarve me familjarët, me një takim në muaj duke respektuar distancën e sigurisë, kontrollin shëndetësor, ku familjari është i detyruar të paraqesë vërtetimin e vaksinimit, ose dokumentin e testit negativ me Covid, me afat 24 orë para apo teste të tjera serologjike që tregojnë se e kanë kaluar infeksionin e Covidit. Gjatë takimeve do të respektohen të gjitha rregullat e tjera antikovid në institucione që do të jenë ende në fuqi. Por gjithashtu do të vijoje të ruhet praktika e krijuar me komunikimin online me Skype.
2. Rifillimin e dhënies së lejeve të veçanta, në zbatim edhe të udhëzimit të miratuar së fundmi në zbatim të ligjit të ri nr. 81/2020, Udhëzim nr.4 , datë 22.01.2021 i ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e procedurave të dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta për të dënuarit”, por kjo situatë do të jetë vetëm për raste mortore gjithmonë sipas parashikimeve ligjore dhe vlerësimit të rrezikshmërisë nga drejtoritë e policisë vendore.
3. Rifillimin e aktiviteteve të përbashkëta, sociale dhe kulturore në mjediset e burgjeve, kjo do të kryhet duke mbajtur në konsideratë dhe duke respektuar distancën e sigurisë dhe rregullat e tjera antikovid, por me qëllim që ti shërbejë rehabilitimit dhe riedukimit të të gjithë personave të cilët ndodhen në institucione, do duhet të rifillojnë këto aktivitete.

Sipas informacionit të marrë “Të gjitha parashikimet e tjera ligjore lidhur me masat e tjera antikovid të parashikuara në urdhërat nr. 91 dhe 92 të datës 09.03.2020 të Ministrit të Drejtësisë do të vijoje të jenë në fuqi”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Kjo ishte vizitë periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin për vitin 2021. Drejtori i institucionit z.Artan Tabaku, pasi u njoh me planin e inspektimit, informoi lidhur me kushtet e trajtimit dhe situatën e respektimit të të drejtave të dënuarve/paraburgosurve në këtë institucion. Në vijim, grupi inspektues kërkoi nga shefat e sektorëve dhe të shërbimeve, vënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit lidhur me organikën, programet vjetore të punës dhe aktiviteteve të sektorit juridik, sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, të shërbimit shëndetësor, sektorit të policisë, etj.

Grupi i inspektimit u informua se në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.8927/1, datë 27.09.2018, “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin është kategorizuar si burg i sigurisë së lartë, me një seksion sigurie të zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin është vendosur dhe sektori për regjimin e posaçëm 41- bis.¹ **Struktura dhe organika** e Institucionit të Ekzekutimit të

¹ .Urdhër Nr.380 datë 19.07.2019 i Ministrit të Drejtësisë. “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në Institucionet e Ekzekutimit të vendimeve Penale.

Vendimeve Penale Peqin² përbëhej nga 359 punonjës nga të cilët 34 ishin punonjës të administratës civile dhe 325 ishin punonjës të policisë së burgjeve.

Aktualisht organika e institucionit kishte mungesa të theksuara në stafin civil dhe në stafin e policisë, ndër këto përmendim:

Stafi Civil

- **Specialist i Regjimit të Posaçëm (1 mungesë)**
- **Specialistë Edukimi (3 mungesa)**
- **Specialiste Finance (1 mungesë)**
- **Zv/ Drejtor**
- **Mjeku në institucion i punësuar part-time**
- **Stomatologunë institucion i punësuar part-time.**
- **Stafi i Policisë mungojnë 40 punonjës sigurie.** Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës nga inspektimi në regjimin e brëndshëm në të gjitha seksionet konstatoi se ka një mungesë të theksuar të stafit të sigurisë dhe nuk është në përpjestim të drejtë numri midis stafit policor dhe numrit të përgjithshëm të të dënuarve referuar udhëzimeve të “Rekomandimit 1999 (22) të Këshillit të Evropës³”. Theksojmë se “Punonjës i Policisë së Burgjeve”, janë ata punonjës të Policisë së Burgjeve, në nivel qendror dhe IEVP-je, të cilët ushtrojnë detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse, mbështetëse apo ekzekutuese për garantimin e rendit e të sigurisë në IEVP.

Në “Situatë emergjente”, një situatë e rrezikshme që përbën një kërcënim serioz, që ndikon ose mund të ndikojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në jetën dhe/apo shëndetin e të dënuarve, paraburgosurve të punonjësve të Policisë së Burgjeve, të punonjësve të tjerë apo të personave të tjerë të pranishëm në IEVP, masat e marra duhet të shkojnë drejt rritjes së numrit dhe jo e kundërta. Rezulton se nuk mund të përballohet me këtë mungesë të theksuar të punonjësve të policisë në IEVP-Peqin.

Shqetësuese ishte mungesa e mjekëve me kohë të plotë në shërbimit shëndetësor, pasi kërkesat dhe nevojat shëndetësore e të dënuarve ishin të shumta. Kjo situatë vijonte e tillë nga muaji Tetor i viti 2018, Institucioni i Avokatit të popullit për vite me rradhë 2018, 2019, 2020 ka rekomanduar për IEVP Peqin “Marrjen e masave për plotësimin e vëndit vakant të mjekut”.

Nga informacioni i marrë, në ditën e inspektimit numri i personave që vuanin dënimin në këtë institucion ishte 409 të dënuar/paraburgosur nga 550 persona që ishte kapaciteti fizik i tij. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin është i përbërë nga 4 seksione dhe konkretisht seksioni i sigurisë së lartë, seksioni i sigurisë së zakonshme me të dënuar, seksioni i të paraburgosurve si dhe seksioni i kujdesit të veçantë (SKV) për akomodimin e personave me probleme të shëndetit mendor.

Gjendja e në IEVP Peqin për 6-mujorin e fundit paraqitet si më poshtë:

- ***Muaji Janar 414 persona***

² Nr. Total i organikës së miratuar me urdhër Nr.43 dt. 25.03.2021 të Kryeministrit.

³<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>

- ***Muaji Shkurt 414 persona***
- ***Muaji Mars 401 persona***
- ***Muaji Prill 413 persona***
- ***Muaji Maj 414 persona***
- ***Muaji Qershor 409 persona***

Nga të dhënat e treguara më lart rezulton se në këtë institucion nuk ka mbipopullim dhe se është nën kapacitet. Ndërkohë ndarja sipas sektorëve paraqiste disa problematika të cilat do të analizohen më poshtë.

Nisur nga problematika e konstatuara gjatë kësaj vizite monitoruese, informacionet e marra nga drejtori dhe stafi i institucionit, si dhe intervistave konfidenciale të zhvilluara me personat e privuar nga liria, rezultoi se rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, “Rekomandimi datë 11.06.2020, nr.doc 2020000228” ishin adresuar si më poshtë:

Nuk ishin ishin marrë masat për⁴:

1. Plotësimin e organikës të institucionit me mjekë të përgjithshëm me kohë të plotë dhe mjek stomatolog për t’ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të të dënuarve/paraburgosurve për vizita mjeksore dhe ofrimin e një shërbimi shëndetësor sa më cilësor.
2. Për nënshkrimin e një marrëveshje të Institucionit me Spitalin Psikiatrik Elbasan, për prezencën e një mjeku psikiatër të paktën një herë në muaj, me qëllim trajtimin mjekësor të personave me probleme të shëndetit mendor kundrejt specifikave mjekësore, si dhe për parandalimin në kohë të ecurisë së sëmundjeve të shëndetit mendor.
3. Riparimin e kokave të dusheve në ambientet e përbashkëta, zëvendësimin e bolierëve të prishur, si dhe ndërrimin e pllakave të amortizuara, dhe eliminimin e lagështirës të theksuar.
4. Plotësimin e mjedisit të punës së punonjësve të sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, kryesisht klasat e edukimit brenda në seksionet e institucionit, me materiale dhe orëndi të nevojshme, që ti shërbejnë riedukimit të të dënuarve/paraburgosurve.

Ishin realizuar rekomandimet e mëposhtme:

- *Ishte kryer transferimi në sektorë të personave të dënuar që qëndronin të akomoduar në ambientet e izolimit përtej afateve ligjore, çka përbënte në vetvete trajtim çnjerëzor dhe degradues të këtyre personave.*
- *Ishin zëvendësuar në dhomat e banimit të të dënuarve të dritave të neonit me drita më të zbehta, për të garantuar gjatë natës elementët e sigurisë, por dhe gjumin si një element i rëndësishëm për shëndetin e këtyre personave.*

Trajtimi i të dënuarve/paraburgosurve

Grupi i monitorimit kishte në objektin e punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, identifikimin e rasteve të përdorimit të

⁴ Doc 2020000228/1 prot K5/ I13-2 “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimi i të dënuarve/paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin”.

forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore.

Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit në grup dhe më vetë të dënuarve/paraburgosurve, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve.

Ankesat nga të dënuarit ishin të shumta në numër :

- Ankesa u ngritën nga të dënuarit për ambientet e përbashkëta të dusheve, të cilat ishin pothuajse jashtë funksionit. Përveç faktit që një dush ishte planifikuar mesatarisht për 20 të dënuar, kokat e dushit ishin të dëmtuara dhe gjendja teknike e mureve dhe pllakave në këto ambiente, ishte e amortizuar. Në këto kushte, pajisjet e dusheve si bolierët dhe kokat e dusheve, ishin siguruar nga vetë të dënuarit/paraburgosurit. Ndërkohë që dhe kushtet higjieno-sanitare të këtyre ambienteve nuk ishin të mira. Ato nuk ishin të lyera dhe as të dizinfektuara.
- Ankesa mbi lagështirën në të **gjitha** dhomat e vuajtjes së dënimit, veçanërisht në ambientet e paraburgimit dhe seksionin e sigurisë së zakonshme. Këto ambiente kishin nevojë për riparime pasi kishin lagështirë dhe tualetet brenda dhomave kërkonin riparime për të garantuar higjienën e nevojshme.
- Ankesa për mosfunksionim e sistemit qendror ngrohje/ftohje të ambienteve të banimit në këtë institucion, për t'iu përshtatur kushteve klimaterike. Në mungesë të tij, ngrohja/ftohja në dhoma kryhej me pajisje të siguruara nga vetë të dënuarit/paraburgosurit.
- Ankesa kishte edhe për numrin e kufizuar të aktiviteteve rekreative në institucion, kryesisht nga të dënuarit e seksionit të sigurisë së lartë. Ata ngritën si shqetësim mungesën e aktiviteteve edukuese, por dhe të aktiviteteve kulturore dhe sportive. **Ata ndjeheshin pothuajse të izoluar** dhe i vetmi aktivitet për këtë kategori ishte orari i ajrimit.
- Ankesa kishte nga të dënuarit dhe të paraburgosurit të cilët nuk kishin aksesin e duhur në shërbimin mjekësor, pavarësisht rekomandimeve të bëra ndër vite për këtë çështje.
- Ankesa kishte për vonesën në vizita me Stomatologun në Institucion⁵.
- Ankesa kishin për moszbatimin e skemës së furnizimit me ilaçe, pasi të dënuarit e sëmurë nuk e merrnin këtë shërbim në kohën e duhur dhe për efekt shpejtësie ata i siguronin ilaçet nga familjarët e tyre.

⁵ “Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet. Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Institucioni Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin kishte 1 dhomë veçimi me kapacitet për 2 persona, 4 dhoma observimi me kapacitet për 4 persona dhe 10 dhoma izolimi për personat e dënuar me masë disiplinore. Lidhur me kushtet në këto ambjente, grupi i inspektimit konstatoi se ishin bërë disa ndryshime. Ato ishin lyster, dhe ishin pajisur me dyshegë batanije dhe jastëk.

Masat mbrojtëse

Grupi monitorues vlerësoi dhe krahasoi me standardet ligjore masat mbrojtëse të përdorura në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin. Sipas informacionit të marrë dhe nga verifikimi në vend i praktikave respektive, rezultoi se pranimi i të dënuarve në institucion bëhej duke respektuar standardet ligjore të parashikuara në aktet ligjore. Komisioni i pritjes së të dënuarve/paraburgosurve në institucion funksiononte sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Nga intervistat në grup dhe në privatësi me të dënuarit/paraburgosurit, u konstatua se nuk kishte raste të përdorimit të tepruar të forcës apo dhunës psikologjike nga ana e punonjësve të shërbimit të policisë së këtij institucioni dhe nuk kishte ankesa në drejtim të rasteve të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, nga stafi i këtij institucioni.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të dënuarit/paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit të kujdesit dhe shërbimit social. Punonjësi i dërgonte ato brenda ditës në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit ose punonjësit e institucionit zhvillonin takimet sipas rasteve. Brenda në regjim kishte kuti postare ku mund të hidheshin ankesat/kërkesat nga të dënuarit/paraburgosurit drejtuar familjarëve të tyre apo institucioneve të tjera shtetërore.

Përsa i takon objektit të këtyre kërkesave, rezultoi se ato konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese të cilat ishin edhe më të shumtat në numër, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatët, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer etj. Grupi monitorues konstatoi se në ambientet e të dënuarve të këtij institucioni kishte mungesa të posterave për njohjen dhe informimin me të drejtat e tyre.

Në këtë institucion, sistemi i monitorimit të ambienteve me kamera ishte funksional, por për shkak të infrastrukturës të ndërtimit të godinave paraqiste probleme. Nga inspektimi u konstatua se, hapësira e shkallëve zbritëse të katit të dytë të sektorëve të sigurisë së lartë dhe sigurisë së zakonshme për në ambientet e ajrimit, nuk ishte e monitoruar me kamera. Gjithashtu në ambientin e infermierisë ku mbahen personat e shtruar dhe në korridorin e dhomave të pacientëve, nuk kishte monitorim me kamera.

Theksojmë se mbikqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në një IEVP, përveç atyre mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjeshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgje dhe paraburgime, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Për sa i përket ambienteve të tjera në rregjim, veç ambientit të dhomave të banimit, klasave, dhomave të edukimit, palestrave, ambienteve të përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve institucioni kishte 8 dhoma observimi/veçimi, për akomodimin e të dënuarve me konflikte në regjim të cilët nuk kishin gjetur ende përshtatshmëri.

Nga intervistimi i të dënuarve/ paraburgosurve u kërkua prezenca më e madhe e punonjësve të sektorit juridik në lidhje me kërkesat për dhënien e konsulencave juridike, pasi një pjesë e tyre nuk kishin mundësi financiare për marrjen e avokatëve private. Ndaj ata kërkonin prezencë me të shpeshtë të punonjësve të sektorit juridik për të përmbushur brenda afateve ligjore kërkesat apo apelimet gjyqësore.

Takimet me familjarët në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin kishin filluar të zhvilloheshin që prej datës 14 qershor por përsëri me numër të kufizuar.

Për muajin maj komunikimi i të burgosurve me familjarët dhe të afërmit,

- ✓ numri i komunikimeve me familjarët në skype gjatë muajit - 744
- ✓ numri i të dënuarve që kanë marrë ushqime nga familjarët përgjatë muajit - 384

Në ambientin e takimeve të sigurisë së lartë dhe atij të sigurisë së zakonshme, për të dënuarit dhe familjarët e tyre, ishin krijuar dhoma për takime me nga 3 sportele për secilën, dhoma për takimet speciale të të dënuarve me bashkëshortet apo bashkëjetueset e tyre, si dhe dhoma për prindërimin në distancë. Këto ambiente ishin të lyera dhe të pajisura me të gjitha orenditë e nevojshme.

Dhoma për prindërimin në distancë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të dënuarit/paraburgosurit qëndronin ulur, duke patur kontakte të drejtëpërdrejta me fëmijët e tyre. Gjatë takimeve respektohej privatësia dhe takimet zhvilloheshin pa barriera apo kufizime fizike.

Në këtë institucion kishte 57 persona të privuar nga liria në marrëdhënie pune në pozicionet si më poshtë:

1. Ndhmës kuzhinier;
2. Shpërndarës ushqimi kati i dytë;
3. Shpërndarës ushqimi kati i tretë;

4. Ndhmës kuzhinier;
5. Puntor Lavanterie;
6. Mirëmbajtës;
7. Magazinier;
8. Sanitar.

Këto shtetas kompesoheshin sipas skemës 3.9 ditë (heqje nga vuajtja e dënimit) pasi nuk aplikohet dhënia e një pagese konkrete në përputhje dhe në varësi të punës së kryer me kompesim në vlerë monetare. Gjithashtu asnjë nga personat e punësuar nuk rezultonte i siguruar nga instancat përkatëse në (ISSH), pasi mungonin aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të dënuarve/ paraburgosurve në institucionet penitenciare.

Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve parashikohet në nenet 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në nenin 44 të ligjit të cituar më sipër parashikohet se: “1. I burgosuri ka të drejtën e një shpërblimi mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. 2. I burgosuri ka të drejtë të disponojë lirshëm dyzet për qind të të ardhurave të fituara nga puna.”

Megjithëse në nenin 91 të këtij ligji parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave i akteve nënligjore në zbatim të tij brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi, deri më tani nuk është nxjerrë e miratuar VKM-ja lidhur me kriteret për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Avokati i Popullit thekson se puna dhe kriteret e shpërblimit duhet të parashikohen dhe rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, vendim i cili edhe pse tej çdo afati ligjor, ka shumë vite që nuk është miratuar. Në vijim, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr. 602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj” i cili pritet të zbatohet në vijim nga organet përkatëse.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, në fokus të vizitës së tij kishte edhe monitorimin e kushteve materiale në institucion, si kusht i rëndësishëm për respektimin e standardeve të jetesës të të dënuarve/ paraburgosurve. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin kishte një infrastrukturë të përgjithëshme funksionale me ndarje të rregullta të godinave dhe tërësia e masave të marra garantonin elementët e sigurisë.

Ne regjimin e brendshëm ndodhen:

- Dy godina për akomodimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve
- Godina e observim – infermieri
- Observimi ka 6 dhoma, infermjeria ka 6 dhoma
- Ndertesa e ambienteve për kryerjen e takimeve familjare të godinës “ A
- Ndertesa e ambienteve për kryerjen e takimeve të godinës “ B “ (ku dhe ndodhen ambientet e nësisë tregëtare private për të dënuarit)
- Godina e lavanderisë dhe kuzhinës
- Dy objekte kulturi

Godina “A” 88 dhoma:

- 64 dhoma ku ndodhen të akomoduar aktualisht 142 të dënuar
- 24 dhoma për akomodimin e të paraburgosurve (Seksioni Paraburgimit) 108 persona.

Godina “B” 120 dhoma nga këto:

- 100 dhoma ku ndodhen të akomoduar aktualisht, siguria e lartë me të dënuar.
- 20 dhoma për Seksionin e mbikqyrjes së posaçme me 2 persona.

Në seksionet e sigurisë së lartë, sigurisë së zakonshme, si dhe në seksionin e paraburgimit baza materiale ishte e plotësuar. Dhomat ishin të kompletuara me shtretër, pajisje dhe orenditë e nevojshme për jetesë. Dhomat e banimit kishin tualete brenda, por në disa dhoma u konstatua mungesa e dyerve në këto ambjente. Për sa i përket dritës dhe ajrit, megjithëse shumica e dhomave ishin të vogla në kubaturë, nuk mungonte ajri dhe drita natyrale.

Në ambientet e banimit mjetet akomoduese si tavolinë dhe karrige, paraqiteshin në gjendje të mirë. Ndërkohë shtrojet ishin të vjetëruara, ndërsa batanijet dhe çarçafët një pjesë e konsiderueshme e të dënuarve i siguronin nga familjet e tyre.

Në ambientin e paraburgimit në momentin e inspektimit, u konstatuan dhoma që mungesa në pajisje, si dollape për rroba. Në kushtet e mungesës së tyre të paraburgosurit i mbanin teshat në qese plastike ose në thes, kryesisht poshtë shtretërve. Edhe në këtë sektor gjendja e çarçafeve, jastëkëve, shtrojeve dhe shtretërve, linte për të dëshiruar. Prezenca e insekteve (furrtareve) ishte një problem në të gjithë institucionin. Korridoret në tërësi ishin të pastra, por qelitë ishin të palyera. Të paraburgosurit shfaqën përsëri të njëjtat ankesa për mosfurnizimin në sasi të mjaftueshme me produkte të higjenës së përbashkët dhe personale.

Ndriçimi artificial në institucion ishte zëvendësuar në dhomat e banimit të të dënuarve të dritave të neonit me drita më të zbehta, për të garantuar gjatë natës elementët e sigurisë, por dhe gjumin si një element i rëndësishëm për shëndetin e këtyre personave.

Kjo më herët përbënte shqetësim për të dënuarit në periudhën e gjumit, pasi ndiçimi ishte i fortë dhe gjatë natës drita për arsye sigurie duhet të qëndrojë e hapur. Lidhur me këtë shqetësim, rekomandojmë që dritat e neonit të zëvendësohen me drita më të zbehta që siguria mos të cënohet, por dhe periudha e gjumit është një element i rëndësishëm për shëndetin e këtyre personave.

Godina e banimit të paraburgosurve, në dhomat e banimit ishin akomoduar deri në 4 deri në 6 persona, në maksimumin e kapacitetit të tyre. Ky rast përbën shkelje të standardit ligjor lidhur me sipërfaqen dhe kubaturën e banimit për një person⁶, si dhe është në kundërshtim me rekomandimet e bëra nga CPT për Shqipërinë.⁷

⁶ Shiko nenin 30 pika 1 e VKM nr. 437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

⁷ Albania: Visit 1997 [par.127] Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) pranë Këshillit të Europës me rastin e vizitës në Shqipëri, në vitin 1997, i ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare:

Theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) shprehet se norma minimum e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m² për dhomat për një person, dhe 4 m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2 m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5 m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës.⁸

Dushet ishin të përbashkëta për çdo seksion. Në shumicën e rasteve të dënuarit larjen e trupit e kryenin në dhoma duke ngrohur ujin me pajisjet e siguruara nga vetë ata. Në ambientet e dusheve kishte lavamanë me katër ose pesë dushe, por funksional ishin një ose dy prej tyre. Në këto ambiente, vihej re prania e lagështirës, amortizimi i pllakave, si dhe mungesa të kokave të dusheve. Nga intervistat e kryera me të dënuarit në të gjitha sektorët u pohua se dushi realizohej përgjithësisht një herë në javë.

Furnizimi me energji elektrike e ambienteve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, ngelet një problem serioz. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm, sikurse u informuam, në këtë institucion vazhdonte të ishte me orar të reduktuar (dy orë, tre herë në ditë). Ndërsa furnizimi me energji elektrike kishte problem me linjën kryesore të furnizimit pasi ishte e dëmtuar. Ankesa kishte edhe në lidhje me mungesën e ujit të ngrohtë në dushet e përbashkëta, ku si rezultat i ngarkesës (mesatarisht 1 dush për 20 persona) mundësia e përdorimit të tyre nga të dënuarit dhe të paraburgosurit ishte e pamjaftueshme, megjithëse ishin marrë masa që të realizohej dushi sipas një grafiku 2 herë në javë.

Ngrohja në dhoma në periudhën e dimrit realizohej më pajisjet e siguruara nga të dënuarit, pasi mungonte një sistem qëndror për ngrohje me kaldajë. Në ambientet e klasave dhe dhomat ku zhvilloheshin aktivitetet e përbashkëta, ngrohja mungonte.

Spektori i veçimit/observimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin kishte 6 dhoma dhe 12 shtretër. Në sektorin e veçimit/observimit në ditën e inspektimit nuk gjendej asnjë person me masë disiplinore. Në sektorin e izolimit kishte 10 dhoma të pajisura me tualete brenda. Ky seksion kishte ambient ajrimi. Në sektorin e sigurisë të lartë dhe të sigurisë të zakonshme kishte palestra, klasa dhe dhoma këshillimi. Kishte një sallë kompjuterësh dhe të gjithë kompjuterët ishin në gjendje funksionale. Palestrat ishin pajisur me mjete të sjella nga vetë të dënuarit. Aktivitetet sportive që zhvilloheshin në ambientet e ajrimit konsistonin kryesisht në futboll, volejboll dhe lojëra tavoline, sipas programit të miratuar nga sektori i edukimit, por këto aktivitete për shkak të pandemisë covid -19 ishin të reduktuara dhe me pjesmarjen e një numëri të reduktuar të dënuarish/paraburgosurish.

“Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10 m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6 m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi.

⁸ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

E drejta për ushtrimin e riteve fetare, zbatohet rregullisht. Në këtë institucion ishin krijuar 2 ambiente kulturi, respektivisht për besimtarët muslimanë e të krishterë. Këto ambiente ishin me hapsirë të bollshme, kishin ndriçim dhe ishin të pajisur me materialet e nevojshme. Këto rite kryheshin rregullisht sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve fetare të zonës.

Cilësia e ushqimit në institucion dhe shërbimi i vakteve gjatë ditës, ishte një nga aspektet që u monitorua gjatë vizitës inspektuese. Nga intervistat me të dënuarit/paraburgosurit kishte pretendime për mungesën e larmisë, nga vizita në kuzhinën e institucionit rezultoi se ushqimi i përgatitur për vaktin e drekës ishte i cilësisë së kënaqshme dhe mjedisi ishte i lyster dhe i pastër. Normat e ushqimit dhe menuja ishin të afishuara në mur. Personeli i kuzhinës ishte i pajisur me uniformë dhe doreza pune, si dhe me librezë shëndetësore. Kampionet e ushqimit ndodheshin sipas vakteve në frigorifer, të mbyllur me çelës. Të sëmurët diabetik trajtoheshin me gatim të diferencuar, por grupi i inspektimit nuk konstatoi ruajtjen e kampioneve të ushqimit për këtë kategori. Kuzhina ishte e pajisur me aspiratorë, por nuk ishte në gjendje pune të plotë, për shkak të difekti teknik. Një problematikë tjetër, ishte dhe mungesa e ujit të ngrohtë në çezma, e nevojshme për larjen e enëve të kuzhinës, pasi bolieri që i furnizonte ishte djegur dhe nuk punonte. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës së institucionit, rezultuan në gjendje të mirë.

Në këtë institucion, funksiononte një lavanderi e cila përdorej për të plotësuar nevojat e institucionit për larjen e teshave personale dhe kryesisht çarçafet dhe batanijet për të dënuarit/paraburgosurit. Nga 4 lavatriçe që ndodheshin në këtë ambient, vetëm 2 ishin në gjendje pune, larja e teshave kryhej nga të dënuar të punësuar.

Regjimi dhe aktivitetet

Gjatë inspektimit u vu re se regjimi ditor në këtë institucion zhvillohet sipas orarit të veprimeve të miratuar nga drejtori i institucionit. Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nga siguria që ata kishin dhe aktivitetet e zhvilluara.

Sipas programit të aktiviteteve, në ambientin e ajrimit zhvilloheshin kryesisht aktivitete të përbashkëta që përfitonin të dënuarit/paraburgosurit si ndeshje futbollit dhe volejbollit. Ndërsa, në dhoma dhe klasat e edukimit të dënuarit ndiqnin programet e televizorit, lojërat e tavolinës etj. Aktivitetet kryesore zhvilloheshin me rastin e festave e datave të rëndësishme ose festave fetare.

Në lidhje me orarin e ajrimit u konstatuan se ajrimi ditor zgjaste deri 3 (tre) orë dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma, të pyetur për aktivitetet apo programet që ata merrnin pjesë, kërkuan që aktivitetet e përbashkëta edukative ose sportive të jenë të larmishme, të kenë më shumë mjete dhe pajisje sportive në dispozicion të tyre, si dhe më shumë orë qëndrimi në ambientin e ajrimit.

Është për tu theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të*

kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”⁹.

Në lidhje me trajnimet profesionale në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, për periudhën e inspektimit, konstatuam se nuk ishte ofruar asnjë kurs profesional nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional në Elbasan. Grupi i inspektimit u informua se me institucioni i kishte drejtuar shkresën me Nr.1219 prot datë 30.04.2021 “Drejtorisë Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Elbasan”, mbi bashkëpunimin për formimin profesional të të burgosurve.

Librat që gjendeshin në inventarin e bibliotekës viheshin në dispozicion të të paraburgosurve apo të dënuarve për lexim sipas kërkesave. Një pjesë e të paraburgosurve dhe të dënuarve ishin regjistruar dhe kishin hapur kartelë personale nëpërmjet të cilës ata tërhiqnin dhe dorëzonin librat.

Gjatë vizitës në regjim grupi inspektues u takua me stafin e sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, ndër ta mungonin 3 punonjës çka përbënte një problem për ofrimin e shërbimit në kohë dhe cilësor ndaj personave që vuajnë dënimin në këtë institucion. Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta në raport me numrin e personave dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale dhe këshillime në klasa.

Një problem që evident për sektorin e kujdesit social ishte mungesa materialeve dhe mjeteve të veçanta brenda në seksione për punën individuale dhe në grup me të dënuarit/paraburgosurit, mungesë që ndikon në mënyrë të vecantë impaktin e punës së stafit psikosocial me të dënuarit.

Në përfundim të vizitës, grupi inspektues u njoh me dokumentacionet e këtij sektori, mbi aktivitetet dhe programet vjetore dhe mujore që zbatoheshin në institucion si dhe shqyrtoi me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të paraburgosurve/dënuarve, kopje të të cilave u administruan nga grupi i inspektimit.

Shërbimi mjekësor

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Peqin, si dhe nga intervistat me të dënuarit, u konstatuan problematika lidhur me shërbimin shëndetësor. Ankesat konsistonin kryesisht në mungesën e mjekut në institucion, vonesat në përgjigjen për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe disa mungesa në medikamente të cilat shpesh mbuloreshin me kontributet e sjelljes nga familjarët e tyre.

Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte njësoj për të gjithë personat që vuanin dënimin në këtë institucion. Të dënuarit ishin të pajisur me librezat shëndetësore, ndërsa të paraburgosurit kishin vështirësi për zbatimin e kësaj skeme, për shkak të vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale.

⁹ *Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>*

Organika e sektorit shëndetësor përbëhej nga 13 punonjës, prej të cilëve 3(tre) mjekë, 1 (një) stomatolog, 1(një) ndihmës mjek/farmacist, 1(një) laborant dhe 8 ndihmësmjekë, por ditën e inspektimit ekspertët e MKPT konstatuan se kishte mungesa në stafin mjekësor: Aktualisht në organikën e stafit mjekësor mjeku ishte i punësuar me kohë të pjesshme në institucion po ashtu edhe Stomatologu ishte punësuar me kohë të pjesshme.

Nga intervistat me të dënuarit problematika më shqetësuese ishte mungesa e mjekut në institucion. Mungesa e mjekut me kohë të plotë, kishte sjellë për pasojë vonesa të përgjigjeve ndaj kërkesave për vizita mjeksore, si dhe për konsultat jashtë institucionit me mjekë specialiste në spitalin e rrethit, dhe më shqetësuese është mungesa e mjekut në situata emergjente, kohë kur mund të ketë situata të rënduara në shëndetin nga të dënuarit.

Skema e medikamenteve të rimbursueshme funksiononte konform Marrëveshjes Trepalëshe (Drejtor i IEVP – DRSKSH - Depo Farmaceutike). Lidhur me medikamentet të cilat nuk janë pjesë e Skemës së Rimbursueshme, institucioni e kryente blerjen e tyre përmes fondit të posaçëm për rastet në fjalë. Në I.E.V.P. Peqin personat të cilët përfitonin nga skema e rimbursimit ishin 93.

Aktualisht në I.E.V.P. Peqin janë të sëmurë Kronik 96 të dënuar dhe të paraburgosur, nga këto:

- Kardiologji – 45 persona
- Endrikrinologji - 18 persona
- Shëndeti Mendor – 38 persona
- Përdorues Metadoni- 8 persona

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash themeltar, regjistri i të sëmurëve kronike, si dhe regjistri për konsultat që mbahen jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull, po ashtu edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve ky institucion referuar numrit të lartë të personave me probleme të shëndetit mendor, ka problem thelbësor mos prezencën e një mjeku psikiatër për vizita periodike. Duke marrë shkas nga numri i lartë i të sëmurëve, specifika e institucionit dhe dinamika e lartë e problematikave tek të paraburgosurit/dënuarit lidhur me gjendjen e tyre emocionale apo problemet e mbartura gjatë vuajtjes së dënimit në një kohe relativisht të gjatë, prezenca e psikiatrit ishte e domosdoshme pasi mund të ndihmojë në parandalimin e agravimit të gjendjes të shëndetit të tyre mendor. KY shërbim mundësohet vetëm në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (IVSHB) Tiranë, ndërkohë që Spitali Psikiatrik Elbasan, si spitali më i afërt, mund ta mundësojë këtë shërbim përmes një marrëveshjeje ndërinstytucionale e cila nuk ishte bërë ende e mundur.

Mungesa e mjekut në institucion ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli i mesëm shëndetësor nuk mund t'i përballojë, e cila citohet edhe në qëndrimet e KPT (CPT) parashikon që: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Në këtë aspekt, është për tu theksuar dhe Rregullorja Evropiane e Burgjeve e cila shprehet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹⁰.

Shërbimi shëndetësor në I EVP Peqin ofrohej në një ambient të veçantë i cili shërbente si spital. Aty kishte 4 dhoma të cilat akomodonin të dënuarit, që ishin të shtruar me probleme të shëndetit, sipas rekomandimit të mjekut. Po ashtu, institucioni kishte 2 seksione të kujdesit të veçantë (SKV), një ishte në seksionin e sigurisë të lartë dhe një në seksionin e sigurisë të zakonshme. Kushte e përgjithshme në këto ambiente ishin të mira. Dhomat e pacientëve mbaheshin të pastra e me rregull nga personeli sanitar i stafit shëndetësor. Institucioni ishte i paisur me një Ambulance. Dhoma e mjekut, dhoma e stomatologut dhe farmacisë ishin të rregullta dhe të mirëmbajtura. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me unit, autoklavë, të cilat funksiononin mirë, por mungonin materialet dhe instrumentet dentare dhe kryesisht materialet për riparime.

Në fund të vizitës, grupi i inspektimit zhvilloi një takim përmbyllës me drejtorin e e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, me të cilin u biseduan të gjitha problematikat e hasura gjatë inspektimit, për të cilat drejtuesi i këtij institucioni i vlerësoi dhe u angazhua se, në bashkëpunim me stafin do të ndërmerren masat e menjëhershme për t'i zgjidhur çështjet që i përkisnin detyrave dhe përgjegjësive të tij institucionale të ngarkuar me ligj.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; nenit 21/b të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, nenin 74/1, pika “b”, të Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”*, ku ndë të tjera parashikohet se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtëruar”*, referuar gjithashtu neneve 24, 26, 27, 28,33, 35, 41, 39 dhe 42 të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”*, i ndryshuar, si dhe pikave 22, 23, 24, 26, 27, 29, 32, 59 dhe 57 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 25.3.2009, i ndryshuar,

¹⁰ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të institucionit me 3 mjekë të përgjithshëm dhe mjek stomatolog me kohë të plotë, për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të të dënuarve/paraburgosurve për vizita mjeksore dhe ofrimin e një shërbimi shëndetësor sa më cilësor.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për rekrutimin në kohë të personelit me 3-specialistë edukimi, sipas organikës të miratuar në IEVP Peqin.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së punonjësve të policisë të rolit bazë.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për nënshkrimin e një marrëveshje të Institucionit me Spitalin Psikiatrik Elbasan, për prezencën e një mjeku psikiatër të paktën një herë në muaj, me qëllim trajtimin mjeksor të personave me probleme të shëndetit mendor kundrejt specifikave mjeksore, si dhe për parandalimin në kohë të ecurisë së sëmundjeve të shëndetit mendor.
5. Marrjen e masave të nevojshme për vënien në zbatim të plotë të skemës tre-palëshe të rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit
6. Marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e kokave të dusheve në ambientet e përbashkëta, zëvendësimin e bolierëve të prishur, si dhe ndërrimin e pllakave të amortizuara, eliminimin e lagështirës në ambientet e brendshme të tyre.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e higjienës në tualetet e dhomave të banimit të paraburgosurve/dënuarve.
8. Të merren masa të menjëhershme për shpërndarjen e të paraburgosurve, me qëllim që personat që akomodohen në dhomat e banimit të këtij institucioni, t'u garantohet trajtimi njerëzor dhe njëkohësisht sa më dinjitoz i tyre.
9. Marrjen e masave për mbikqyrjen e vazhdueshme të veprimtarisë të njësisë tregtare në I.E.V.P, Peqin për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit.
10. Marrjen e masave të menjëherëshme për pajisjen e plotë të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve me orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin me ngrohje të përshtatshme të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Peqin për t'iu përshtatur kushteve klimaterike.
12. Marrjen e masave të menjëhershme për të plotësuar mjediset e punës të punonjësve të sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, kryesisht klasat e edukimit brenda në seksionet e institucionit, me materiale dhe orendi të nevojshme, që ti shërbejnë riedukimit të të dënuarve/paraburgosurve.
13. Marrjen e masave për mundësimin e kurseve profesionale në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e të paraburgosurve/dënuarve në jetën sociale.
14. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në ambientet e dhomave të banimit dhe të dusheve.
15. Marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Peqin në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 date 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi, brenda afatit ligjor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

ERMONELA XHAFA